

UDHËZIM
Nr. 12, datë 6.1.2017

PËR MATERIALE DHE ARTIKUJ
PLASTIKË TË PËRCAKTUAR TË JENË
NË KONTAKT ME USHQIMIN¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kërkesat specifike për prodhimin dhe tregtimin e materialeve dhe artikujve plastike:

a) të përcaktuara të jenë në kontakt me ushqimin; ose

b) janë tashmë në kontakt me ushqimin; ose

c) të cilat ka arsye të pritët të jenë në kontakt me ushqimin.

2. Ky udhëzim do të aplikohet për materialet dhe artikujt të cilët ndodhen në treg dhe janë pjesë e kategorive të mëposhtme:

a) materialet, artikujt dhe pjesët e tyre që përbëhen vetëm (ekskluzivisht) prej plastike;

b) materiale dhe artikuj plastike me shumë shtresa të mbajtura (kapura) së bashku nga ngjitëse ose me mjete të tjera;

c) materiale dhe artikuj, referuar germave “a” dhe “b”, të pikës 2, që janë printuar dhe/ose mbuluar nga një shtresë;

d) shtresa plastike ose veshje plastike, duke formuar rondele në kapak dhe mbyllje, që së bashku me kapakun dhe mbylljen përbëjnë një grup prej dy ose më shumë shtresa të llojeve të ndryshme të materialeve;

e) shtresa plastike shumë materiale, me shumë shtresa materialesh dhe artikujsh.

3. Ky udhëzim nuk aplikohet në materialet dhe artikujt e mëposhtëm, të cilët ndodhen në treg dhe mbulohen nga masa të tjera specifike:

a) jon-shkëmbyes i resinave;

b) kauçuku;

c) silikoni.

4. Ky udhëzim nuk cenon dispozitat e aplikuara

për bojën e printimit, ngjitësit ose mbulesat.

5. Ky udhëzim është një masë specifike brenda kuptimit të pikave 11 dhe 12, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012 “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”.

6. Për qëllime të këtij udhëzimi, do të përdoren termat e mëposhtëm:

a) “Materiale dhe artikuj plastike” janë :

i) Materialet dhe artikujt referuar në germat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij udhëzimi; dhe

ii) Shtresat plastike referuar pikës 2/d dhe “e” të këtij udhëzimi;

b) “Plastik” është një polimer në të cilin mund të jenë shtuar aditivë ose substanca të tjera, që është i aftë për të funksionuar si një komponent kryesor strukturor i materialeve dhe artikujve përfundimtare;

c) “Polimer” është çdo substancë makromolekulare e marrë nga:

i) një proces polimerizimi i tillë si poli-shtesë ose poli-kondensim, ose nga ndonjë proces tjetër i ngjashëm i monomereve dhe substancave të tjera fillestare, ose;

ii) modifikim kimik i makromolekulave natyrale ose sintetike, ose;

iii) fermentim mikrobial;

d) “Plastike me shumë shtresa” është një material ose artikull i përbërë nga dy ose më shumë shtresa plastike;

e) “Shumë shtresa me shumë material” është një material ose artikull i përbërë nga dy ose më shumë shtresa të materialeve të llojeve të ndryshëm, ku të paktën një prej tyre të jetë shtresë plastike;

f) “Monomer ose substancë tjetër fillestare” është :

i) një substancë që i nënshtrohet çdo lloj procesi polimerizimi për të prodhuar një polimer; ose

ii) një substancë makromolekulare natyrale ose sintetike e përdorur në prodhimin e makromolekulave të modifikuara; ose

iii) një substancë e përdorur për të modifikuar makromolekulat natyrale ose sintetike ekzistuese;

g) “Aditiv” është një substancë e cila është shtuar qëllimisht në plastikë për të arritur një efekt fizik ose kimik gjatë përpunimit të plastikës ose në materialin ose artikullin përfundimtar dhe që mendohet të jetë e pranishme në materialin ose artikullin përfundimtar;

h) “Ndihmës i prodhimit të polimerit” është çdo substancë e përdorur për të siguruar një

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me: Rregulloren e Komisionit nr. 10/2011 e 14 janarit 2011 “Mbi materialet dhe artikujt plastikë që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin”, amenduar me Rregulloren Implementuese të Komisionit (KE) nr. 321/2011 e 1 prillit 2011. CELEX 2011R0010— EN FZ L 12, 15.1.2011, faqe 1

mesatare të përshtatshme për prodhimin e polimerit ose të plastikës; ai mund të jetë i pranishëm por nuk synohet të jetë i pranishëm në materialet ose artikujt përfundimtar dhe as nuk ka një efekt fizik apo kimik mbi materialin ose artikullin përfundimtar;

i) “Substancë e shtuar pa qëllim” është një papastërti (ndotje) në substancat e përdorura ose një reaksion i ndërmjetëm i formuar gjatë procesit të prodhimit ose një produkt dekompozimi ose reaksioni;

j) “Mjet ndihmës për polimerizimin” është një substancë e cila fillon polimerizimin dhe/ose kontrollon formimin e strukturës makromolekulare;

k) “Kufiri i përgjithshëm i migrimit” (KPM) është shuma maksimale e lejuar e substancave të paqëndrueshme të lëshuara nga një material ose artikull në simulantët ushqimorë;

l) “Simulant ushqimor” është një test provë i cili imiton ushqimin; në sjelljen e tij simulanti ushqimor imiton migrimin nga materialet që janë në kontakt me ushqimin;

m) “Kufiri specifik i migrimit” (KSM) është shuma maksimale e lejuar e një substance të dhënë të lëshuar nga një material ose artikull në ushqim ose simulant ushqimor;

n) “Kufiri i përgjithshëm specifik i migrimit” (KPSM) është shuma maksimale e lejuar e substancave të veçanta të lëshuara në produkt ose simulant ushqimor, e shprehur si total i pjesës së substancave të shfaqura;

o) “Pengesë funksionale” është një pengesë që konsiston në një ose më shumë shtresa të çdo lloj materiali e cila siguron që materiali apo artikulli përfundimtar përputhet me pikën 6, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet” dhe me dispozitat e këtij udhëzimi.

p) “Ushqim jo i yndyrshëm” është një ushqim për të cilin në testin e migrimit vetëm simulantët ushqimorë përveç simulantëve D1 ose D2 janë përcaktuar në tabelën 2, të shtojcës V, të këtij udhëzimi;

q) “Kufizim” është kufizim në përdorimin e një substance, ose të kufirit të migrimit ose kufiri i përmbajtjes së substancës në materialin apo artikullin;

r) “Specifikim” është përbërja e një substance, kriteret e pastërtisë për substancë, karakteristikat

fiziko-kimike të substancës, detaje në lidhje me procesin e prodhimit të një substance ose informacionet e mëtejshme në lidhje me shprehjen e kufijve të migrimit.

7. Materialet dhe artikujt plastike vendosen në treg vetëm, në qoftë se:

a) janë në përputhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara në pikën 6, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012 “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”, nën përdorimin e synuar dhe të parashikuar;

b) janë në përputhje me kërkesat e etiketimit të përcaktuara në pikat 13, 14, 15, 16 dhe 17 të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”;

c) janë në përputhje me kërkesat e gjurmimit të përcaktuara në pikat 22 dhe 23, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”;

d) prodhohen në përputhje me praktikatat e mira të prodhimit të përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 8.3.2016, “Mbi praktikatat e mira të prodhimit për materiale dhe artikuj që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin”;

e) janë në përputhje me kërkesat e përbërjes dhe deklarimit të përcaktuara në pikat 8–46 të këtij udhëzimi.

8. Vetëm substancat e përcaktuara në shtojcën 1 të përdoren në prodhimin e shtresave plastike në materialet dhe artikujt plastike.

9. Shtojca 1 përmban:

a) monomerët ose substanca të tjera fillestare;

b) aditivët, përjashtuar ngjyruesit;

c) ndihmësit në prodhimin e polimerit, përjashtuar tretësit;

d) makromolekulat e përfituara nga fermentimi mikrobik.

10. Shtojca 1 ndryshon në përputhje me ndryshimet e bëra në legjislacionin e Bashkimit Europian.

11. Pa përjashtuar pikat 8, 9, 10, substanca të tjera përveç atyre të përfshira në shtojcën 1, mund të përdoren si mjete ndihmëse të prodhimit polimer në prodhimin e shtresave plastike në materiale dhe artikuj plastike, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Pa përjashtuar pikat 8, 9, 10, ngjyruesit dhe tretësit mund të përdoren në prodhimin e shtresave plastike në materialet dhe artikujt plastike sipas legjislacionit në fuqi.

13. Substancat e mëposhtme, të pa përfshira në shtojcën 1, janë të autorizuar t'ju nënshtrohen rregullave të përcaktuara në pikat 16–24 të këtij udhëzimi:

a) kripërat (duke përfshirë kripërat e dyfishta dhe kripërat acide) e aluminit, amonit, bariumit, kalciumit, kobaltit, bakrit, hekurit, litiumit, magnesit, manganit, kaliumit, natriumit, dhe zinkut, të acideve, fenoleve ose alkooleve të autorizuar;

b) përzierja e fituar nga përzierja e substancave të autorizuar pa reaksione kimike të përbërësve;

c) kur përdoren si aditivë, substanca polimere natyrale ose sintetike me peshë molekulare prej të paktën 1000 Da, përveç makromolekulave të fituara nga fermentimi mikrobik, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, nëse janë të afta të funksionojnë si element kryesor strukturor i materialeve ose artikujve përfundimtare;

d) kur përdoren si monomer ose substanca të tjera fillestare, parapolimere dhe substanca makromolekulare natyrale apo sintetike, si edhe përzierjet e tyre, përveç makromolekulave të përfituara nga fermentimi mikrobik, nëse monomeret ose substancat fillestare të nevojshme për ti sintetizuar ato janë të përfshira në shtojcën 1.

14. Substancat e mëposhtme të papërfshira në shtojcën 1 mund të jenë të pranishme në shtresat plastike të materialeve ose artikujve plastike:

a) substancat e shtuara pa qëllim;

b) ndihmësit për polimerizim.

15. Pa përjashtuar pikat 8, 9 dhe 10, shtesat që nuk përfshihen në shtojcën 1 mund të vazhdojnë të përdoren sipas legjislacionit kombëtar derisa të merret një vendim për përfshirjen ose jo të tyre në shtojcën 1 me kusht që ato të përfshihen në listën e përkohshme të përmendur në pikat 16 dhe 17.

16. Substancat e përdorura në prodhimin e shtresave plastike në materialet ose artikujt plastikë, të jenë të një cilësie teknike dhe një pastërtie të përshtatshme për përdorimin e synuar dhe të parashikuar të materialeve ose artikujve. Përbërja i bëhet e ditur prodhuesit të substancës dhe vihet në dispozicion të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sipas kërkesës.

17. Substancat e përdorura në prodhimin e shtresave plastike në materialet ose artikujt plastike të respektojnë kufizimet dhe specifikimet e mëposhtme:

a) kufirin specifik të migrimit të përcaktuar në pikat 20, 21 dhe 22;

b) kufirin e përgjithshëm të migrimit të përcaktuar në pikat 23 dhe 24;

c) kufizimet dhe specifikimet e përcaktuara në kolonën 10 të tabelës 1, pikës 1 të shtojcës 1;

d) specifikimet e detajuara të përcaktuara në pikën 4 të shtojcës 1.

18. Substancat në nanoform do të përdoren nëse janë të autorizuar dhe përmendura shprehimisht në specifikimet e shtojcës 1.

19. Kufizimet e përgjithshme në lidhje me materialet dhe artikujt plastike janë të përcaktuara në shtojcën II.

20. Materialet dhe artikujt plastike nuk duhet të transferojnë përbërësit e tyre tek ushqimet në sasi që tejkalojnë kufirin specifik të migrimit të përcaktuar në shtojcën 1. Këto kufij specifik të migrimit (KSM) shprehen në miligramë substancë për kilogram ushqim (mg/kg).

21. Për substancat për të cilat nuk është dhënë kufiri specifik i migrimit ose kufizimet e tjera në shtojcën 1 të këtij udhëzimi, do të aplikohet një kufi i përgjithshëm specifik i migrimit prej 60 mg/kg.

22. Pa përjashtuar pikat 20 dhe 21, aditivët të cilët janë të autorizuar si aditiv ushqimorë sipas udhëzimit nr. 18, datë 17.11.2010, “Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore” ose si aromatizues sipas udhëzimit nr. 7, datë 14.12.2015, “Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimor me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore”, nuk duhet të migrojnë brenda ushqimeve në sasi që mund të përbëjnë ndikim teknik në produktet ushqimore përfundimtare dhe nuk do të:

a) tejkalojnë kufizimet e caktuara nga udhëzimi nr. 18, datë 17.11.2010, “Për aditivët ushqimorë të përdorur në produktet ushqimore” ose udhëzimi nr. 7, datë 14.12.2015, “Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimor me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore”, ose në shtojcën 1 të këtij udhëzimi për ushqime për përdorimin e të cilëve është i autorizuar si aditiv ushqimor ose substancë aromatizuese; ose

b) tejkalojnë kufizimet e përcaktuara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi në ushqime, përdorimi i të cilave nuk është i autorizuar si shtesë ushqimore apo substancë aromatizuese.

23. Materialet dhe artikujt plastike nuk do të transferojnë përbërësit e tyre te simuluesit

ushqimorë në sasi që tejkalojnë 10 miligramë nga përbërësit totale të lëshuar për dm^2 sipërfaqe kontakti me ushqimin (mg/dm^2).

24. Pa përjashtuar pikën 23 të këtij udhëzimi, materialet dhe artikujt plastike të destinuar të jenë në kontakt me ushqimin për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, të përcaktuara nga urdhri nr. 456 datë 17.12.2007, “Mbi miratimin e rregullores “Për formulat ushqimore për foshnja dhe formulat rrjedhëse” dhe urdhri nr. 94, datë 28.3.2010, “Për miratimin e rregullores “Mbi ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për foshnje dhe fëmijë të vegjël””, nuk do të transferojnë përbërësit e tyre të simulantët e ushqimit në sasi që kalojnë 60 miligramë në total prej përbërësve të lëshuar për kg simulant ushqimor.

25. Në një material ose artikull plastik me shumë shtresa, përbërja e çdo shtrese plastike do të jetë në përputhje me këtë udhëzim.

26. Me përjashtim të pikës 25, një shtresë plastike e cila nuk është në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin dhe është ndarë nga ushqimi nga një pengesë funksionale, mund:

a) të mos jetë në përputhje me kufizimet dhe specifikimet e përcaktuara në këtë udhëzim, përveç monomerit të klorur vinilit, siç parashikohet në shtojcën I; dhe/ose

b) të prodhohet me substanca jo të listuara në shtojcën 1.

27. Migrimi i substancave sipas pikës 26 në ushqim apo simulant ushqimor nuk do të jetë e dallueshme e matur me siguri statistikore nga metoda e analizës së përcaktuar në nenin 11, të urdhrit nr. 382, datë 31.7.2006, “Për miratimin e rregullores “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve e të kafshëve dhe rregullat për shëndetin, si dhe mirëqenien e kafshëve”, me një limit zbulimi prej 0.01 mg/kg . Ky kufi gjithmonë do të shprehet si përqendrim në ushqime apo simulantët e ushqimit. Ky kufi do të zbatohet për një grup të komponimeve, nëse ato janë strukturore dhe toksikologjikisht të lidhura, të izomereve të veçanta ose komponimeve me të njëjtin grup funksional të përshtatshëm, dhe do të përfshijë grupet e mundshme të transferimit.

28. Substancat jo të listuara në shtojcën 1, të përmendura në pikën 26/b, nuk i përkasin asnjë prej kategorive të mëposhtme:

a) substancave të klasifikuara si “mutagjene”, “kancerogjene” ose “toksike për riprodhimin”;

b) substancat në nanoform.

29. Materiali ose artikulli plastik përfundimtar me shumë shtresa do të jetë në përputhje me kufijtë e specifik të migrimit të përcaktuara në pikat 20, 21 dhe 22 dhe me kufirin e përgjithshëm të migrimit të përcaktuar në pikat 23 dhe 24 të këtij udhëzimi.

30. Në një material ose artikull shumë-materialesh shumë-shtresash, përbërja e çdo shtrese plastike do të jetë në përputhje me këtë udhëzim.

31. Me përjashtim nga pika 30, në një material ose artikull shumë-materialesh shumë-shtresash shtresa plastike e cila nuk është në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin dhe është e ndarë nga ushqimi nga një pengesë funksionale, mund të prodhohet me substanca jo të listuara në shtojcën 1.

32. Substancat jo të listuara në shtojcën 1 të përmendura në pikën 31 nuk i përkasin asnjë prej kategorive të mëposhtme:

a) substancave të klasifikuara si “mutagjene”, “kancerogjene” ose “toksike për riprodhimin”;

b) substancave në nanoform.

33. Me përjashtim nga pika 30, pikat 20, 21, 22, 23 dhe 24 të këtij udhëzimi nuk zbatohen për shtresa plastike në materialet dhe artikujt me shumë-materiale shumë shtresa.

34. Shtresat plastike në një material ose artikull me shumë materiale shumë shtresa, të jenë në përputhje me kufizimet për monomerin e klorur vinilit të përcaktuar në shtojcën I të këtij udhëzimi.

35. Kufizimet e veçanta dhe të përgjithshme të migrimit për shtresa plastike dhe materiale ose artikuj final në një material ose artikull shumë-materialesh shumë shtresash, përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

36. Në fazat e marketingut përveç fazës së shitjes me pakicë, një deklaratë me shkrim, në përputhje me pikat 21, 22 dhe 23, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”, vihet në dispozicion për materiale plastike dhe artikuj, produktet nga fazat e ndërmjetme të prodhimit të tyre, si dhe për substancat e destinuara për prodhimin e këtyre materialeve dhe artikujve.

37. Deklarata me shkrim e përmendur në pikën 36 do të lëshohet nga operatori i biznesit dhe duhet të përmbajë informacionin e përcaktuar në shtojcën IV të këtij udhëzimi.

38. Deklarata e shkruar do të lejojë identifikimin e lehtë të materialeve, artikujve apo të produkteve nga fazat e ndërmjetme të prodhimit apo substancave për të cilat është lëshuar. Ajo do të rinovohet kur kanë ndodhur ndryshime thelbësore në përbërje ose prodhim, që ka sjellë ndryshime në migrimin nga materialet ose artikujt apo kur janë vënë në dispozicion të dhëna të reja shkencore.

39. Operator i biznesit me kërkesë, do të verë në dispozicion Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), dokumentacionin për të treguar se materialet dhe artikujt, prodhimet nga fazat e ndërmjetme të prodhimit, si dhe substancave të destinuara për prodhimin e këtyre materialeve dhe artikujve janë në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

40. Ky dokumentacion do të përmbajë kushtet dhe rezultatet e testimit, llogaritjeve duke përfshirë modelimin, analiza të tjera, dhe dëshmi të sigurisë ose përputhje të arsyetimit demonstruar. Rregullat për demonstrim eksperimental të pajtueshmërisë janë përcaktuar në pikat 41, 42, 43 dhe 44.

41. Për të kontrolluar përputhshmërinë, vlerat specifike të migrimit do të shprehen në mg/kg aplikim në sipërfaqe për raportin real të vëllimit në përdorim aktual ose të parashikuar.

42. Përfshirë nga pika 41, bëjnë:

a) kontejnerët dhe artikujt të tjerë, që përmbajnë ose që synojnë të përmbajnë, më pak se 500 mililitra ose gramë ose më shumë se 10 litra,

b) materialet dhe artikujt për të cilat, për shkak të formës së tyre është e pazbatueshme për të vlerësuar marrëdhëniet midis sipërfaqes së materialeve ose artikujve të tillë dhe sasinë e ushqimit në kontakt me to,

c) fletë dhe filma që nuk janë ende në kontakt me ushqimin,

d) fletë dhe filma që përmbajnë më pak se 500 mililitra ose gramë ose më shumë se 10 litra,

vlera e migrimit duhet të shprehet në mg/kg aplikuar në sipërfaqe të raportit të vëllimit 6 dm^2 për kg të ushqimit.

Paragrafi më lartë nuk zbatohet për materiale plastike dhe artikujt të destinuar për t'u sjellë në kontakt, ose tashmë janë në kontakt me ushqimin për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, të përcaktuara në urdhrin nr. 456, datë 17.12.2007, "Mbi miratimin e rregullores "Për formulat ushqimore për foshnja dhe formulat rrjedhëse"" dhe urdhrin nr. 94, datë 28.3.2010, "Për miratimin e rregullores "Mbi

ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për foshnje dhe për fëmijë të vegjël"".

43. Me përjashtim nga pika 41, për kapakët, rondelat, tapat dhe artikujt të ngjashëm të vulosur, vlera specifike e migrimit duhet të shprehet në:

a) mg/kg duke përdorur përmbajtjen aktuale të enës për të cilën mbyllja është menduar ose në mg/dm^2 aplikuar në sipërfaqen totale të kontaktit të vulës së artikullit dhe kontejnerit të mbyllur, nëse përdorimi i synuar është i njohur, duke marrë parasysh dispozitat e pikës 42;

b) mg/artikull nëse përdorimi i destinuar është i panjohur.

44. Për kapakët, rondelat, tapat dhe artikujt të ngjashëm të vulosur, vlera e përgjithshme e migrimit duhet të shprehet në:

a) mg/dm^2 aplikuar në sipërfaqen totale të kontaktit të vulës së artikullit dhe kontejnerit të mbyllur nëse përdorimi i parashikuar është i njohur;

b) mg/artikull nëse përdorimi i synuar është i panjohur.

45. Për materialet dhe artikujt tashmë në kontakt me ushqimin, verifikimi i pajtueshmërisë me KSM-në të kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin 1, të shtojcës V, të këtij udhëzimi.

46. Për materialet dhe artikujt jo në kontakt me ushqimin verifikimi i pajtueshmërisë me KSM-në duhet të kryhet në ushqim ose në simulantët e ushqimit të përcaktuar në shtojcën III, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin 2, seksionin 2.1, të shtojcës V, të këtij udhëzimi.

47. Për materialet dhe artikujt jo në kontakt me ushqimin shqyrtimi i pajtueshmërisë me KSM-në do të kryhet duke aplikuar metoda të shqyrtimit në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin 2, seksioni 2.2, të shtojcës V, të këtij udhëzimi. Nëse një material apo artikull nuk është në përputhje me kufijtë e migrimit, në metodat e shqyrtimit përfundimi i mospërputhshmërisë duhet të konfirmohet nga verifikimi i përputhshmërisë, në përputhje me pikën 46 të këtij udhëzimi.

48. Për materialet dhe artikujt jo në kontakt me ushqimin, verifikimi i përputhshmërisë së ushqimit me kufirin e përgjithshëm të migrimit do të kryhet në simulantët ushqimorë A, B, C, D1 dhe D2, siç përcaktohet në shtojcën III, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin 3, seksioni 3.1 i shtojcës V të këtij udhëzimi.

49. Për materialet dhe artikujt jo në kontakt me ushqimin, shqyrtimi i përputhshmërisë me kufirin e përgjithshëm të migrimit do të kryhet duke aplikuar shqyrtimin e qasjes në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin 3, seksioni 3.4, të shtojcës V. Nëse një material apo artikull nuk është në përputhje me kufirin migrimit në shqyrtimin e qasjes konkluzioni i mospërputhshmërisë të konfirmohet nga verifikimi i përputhshmërisë, në përputhje me pikën 48 të këtij udhëzimi.

50. Rezultatet e testimit specifik të migrimit të marra në ushqim do të mbizotërojnë mbi rezultatet e arritura në simulantin ushqimor. Rezultatet e testimit specifik të migrimit të marra në simulantin ushqimor do të mbizotërojnë mbi rezultatet e arritura nga shqyrtimi i qasjes.

51. Para krahasimit të rezultateve të testimit specifik dhe të përgjithshëm të migrimit me kufirin e migrimit, do të zbatohen faktorët e korrigjimit në kapitullin 4, të shtojcës V, të këtij udhëzimi, në përputhje me rregullat e përcaktuara aty.

52. Përputhshmëria me pikën 6, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet” e substancave të përmendura në pikat 9, 10, 12, 13 dhe 31 të këtij udhëzimi të cilat nuk janë të mbuluara nga një përfshirje në shtojcën I të këtij udhëzimi, do të vlerësohen në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare shkencore në vlerësimin e riskut.

53. Simulantët ushqimorë që do të përdoren për testimin e migrimit të përbërësve të materialeve plastike dhe artikujve që janë në kontakt me një ushqim të vetëm apo grupe të caktuara të ushqimeve janë të përcaktuara në pikën 3 të shtojcës III të këtij udhëzimi

54. Udhëzimi nr. 361, datë 23.10.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi materialet dhe artikujt që përmbajnë monomer klorur vinili dhe janë përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimet””, dhe urdhri nr. 476, datë 27.12.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi materialet dhe artikujt plastike të përcaktuar të jene në kontakt me produktet ushqimore””, shfuqizohen.

55. Ngarkohen, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA 1

SUBSTANCAT

1. Lista e autorizuar e monomereve, substancave të tjera fillestare, makromolekulave të fituara nga fermentimi mikrobial, aditivëve dhe mjeteve të prodhimit polimer.

Tabela 1 përmban informacionin e mëposhtëm:

Kolona 1 (Nr. FCM i substancës): numrin unik të identifikimit të substancës.

Kolona 2 (Ref Nr.): numër reference i KEE-së të materialit të paketimit.

Kolona 3 (CAS Nr): numri i regjistrimit të Shërbimit Kimik Abstrakt (SHKA).

Kolona 4 (Emri substancës): emri kimik.

Kolona 5 (Përdoret si aditiv ose mjet prodhimit polimer (MPP) (po / jo)): një tregues nëse substanca është e autorizuar për t'u përdorur si aditiv ose mjet prodhimi polimer (po), ose nëse substanca nuk është e autorizuar për t'u përdorur si aditiv ose mjet prodhimi polimer (jo). Nëse substanca është e autorizuar vetëm si MPP është treguar (po) dhe në specifikimet përdorimi është i kufizuar si MPP.

Kolona 6 (Përdorimi si monomer ose substanca të tjera fillestare ose makromolekula të fituara nga fermentimi mikrobial (po / jo)): një tregues nëse substanca është e autorizuar që të përdoret si monomer ose substancë tjetër fillestare ose makromolekula të fituara nga fermentimi mikrobial (po) ose në qoftë se substanca nuk është e autorizuar për t'u përdorur si monomer apo substancë tjetër fillestare ose makromolekula e përfutur nga fermentimi mikrobial (jo). Nëse substanca është e autorizuar si makromolekulë e marrë nga fermentimi mikrobial tregohet (po) dhe në specifikimet është treguar se substanca është një makromolekulë e fituar nga fermentimi mikrobial.

Kolona 7 (FRY e aplikueshme (po / jo)): një tregues nëse rezultatet e migrimit për substancën mund të korrigjohen nga Faktori i Reduktimit të Konsumit të Yndyrës (FRY) (po), ose në qoftë se ata nuk mund të korrigjohen nga FRY (jo).

Kolona 8 (KSM [mg/kg]): kufiri specifik i migrimit, limiti i zbatueshëm për substancën. Ajo është e shprehur në substance mg/kg ushqim. Është shënuar ND nëse substanca nuk do të migrojë në sasi të dallueshme.

Kolona 9 (KSM (P) [mg/kg] (grupi kufizim Jo)): përmban numrin e identifikimit të grupit të substancave për të cilat zbatohet kufizimi grup në kolonën 1 në tabelën 2 të kësaj shtojce.

Kolona 10 (Kufizimet dhe specifikimet): përmban kufizime të tjera se kufiri specifik i migrimit përmendur në mënyrë specifike dhe ai përmban specifikimet lidhur me substancën. Në rastin e specifikimeve të detajuara janë përcaktuar referenca të përfshirë në tabelën 4.

Kolona 11 (Shënime për verifikimin e pajtueshmërisë): përmban shënime, numër i cili i referohet rregullave të hollësishme të aplikueshme për verifikimin e pajtueshmërisë për atë substancë të përfshirë në kolonën 1 në tabelën 3 të kësaj shtojce.

Në qoftë se një substancë shfaqet në listë si një përbërës individual është gjithashtu e mbuluar nga një term i përgjithshëm, kufizimet që aplikohen për këtë substancë do të jenë ato të paraqitura për përbërësin individual.

Nëse në kolonën 8 kufiri specifik i migrimit është jo-i dallueshëm (ND) një kufi i dallueshëm i 0,01 mg substancë / kg ushqim është i zbatueshëm përveç nëse specifikohet ndryshe për një substancë të veçantë

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
Nr. FCM substance	Nr. Ref.	CAS Nr.	Emri substancës	Përdoren si aditiv ose ndihmës për prodhimin e polimerit (po/jo)	Përdoren si monomer ose si substancë tjetër fillestare ose makromolekula përftuar nga fermentimi mikrobial (po / jo)	FRF e zbatueshme (po/jo)	KSM [mg/kg]	KSM(P) [mg/kg] (kufizimi në grup Nr)	Kufizimet dhe specifikimet	Shënime mbi verifikimin e përpueshmërisë
1	12310	0266309-43-7	albumin	jo	po	jo				
2	12340	—	albumin, e koageluar në formë aldehide	jo	po	jo				
3	12375	—	alkoolet, alifatik, monohidrik, te ngopur, lineare, parësore (C4-C22)	jo	po	jo				
4	22332	—	Perzjerje e (40 % w/w) 2,2,4-trimetilhexane-1,6-diisocianate dhe (60 % w/w) 2,4,4-trimetilhexane-1,6-diisocianate	jo	po	jo		(17)	1 mg/kg në produktin përfundimtar e shprehur si pjesë e isocianatit.	(10)
5	25360	—	trialkil(C5-C15) acid acetik, 2,3- ester epoxipropil	jo	po	jo	ND		1 mg/kg në produktin përfundimtar e shprehur si epoxigrup. Pesha molekulare është 43 Da.	
6	25380	—	esteret e vinil trialkil acid acetik (C7-C17)	jo	po	jo	0,05			(1)

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
7	30370	—	Kripëra të acidit acetil acetik	po	jo	jo				
8	30401	—	mono- acetil dhe diglyceride të acideve yndyrore	po	jo	jo		(32)		
9	30610	—	acidet, C ₂ -C ₂₄ , alifatike, lineare, monokarboksilik nga vajra dhe yndyrna natyrale dhe esteret e tyre mono-, di- dhe trigliceride (janë të përfshira acidet yndyrore të degëzuara në nivele natyrale)	po	jo	jo				
10	30612	—	acidet, C ₂ -C ₂₄ , alifatike, lineare, monokarboksilik, sintetik dhe esteret e tyre mono-, di- dhe trigliceride	po	jo	jo				
11	30960	—	acidet, alifatike, monokarboksilik (C ₆ -C ₂₂), esteret me polyglycerol	po	jo	jo				
12	31328	—	Acidet yndyrore, nga yndyrna ushqimore shitazore apo vajra vegjetale	po	jo	jo				
13	33120	—	Alkoolet, alifatike, monohidrik, të ngopur, lineare, parësore (C ₄ -C ₂₄)	po	jo	jo				
14	33801	—	n-alkil(C ₁₀ -C ₁₃) acid sulfonik benzeni	po	jo	jo	30			
15	34130	—	alkil, lineare me nr çift të atomeve të karbonit (C ₁₂ -C ₂₀) dimetil- aminës	po	jo	po	30			

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
16	34230	—	alkil(C ₈ -C ₂₂) acidet sulfonike	po	jo	jo	6			
17	34281	—	alkil(C ₈ -C ₂₂)acidet sulfonike, lineare, parësore me nr çift te atomeve te karbonit	po	jo	jo				
18	34475	—	Hidroksid kalciumi alumina fosfite, hidrate	po	jo	jo				
19	39090	—	N,N-bis(2-hydroxyethyl)alkyl(C ₈ -C ₁₈) amine	po	jo	jo		(7)		
20	39120	—	N,N-bis(2-hydroxyethyl)alkyl(C ₈ -C ₁₈)amine hidrokloride	po	jo	jo		(7)	SML(T) shprehur me përjashtim HCl	
21	42500	—	Kripa të acidit karbonik	po	jo	jo				
22	43200	—	Vaj recini, mono dhe digliceride	po	jo	jo				
23	43515	—	Kloride të estereve të kolinës të acideve yndyrore të vajit të kokosit	po	jo	jo	0,9			(1)
24	45280	—	Fibra pambuku	po	jo	jo				
25	45440	—	Kresolet, butilatet, stirenatet	po	jo	jo	12			
26	46700	—	5,7-di-tert-butil-3-(3,4- and 2,3-dimetilfenil)-3H-benzofuran-2-qe permban: a) 5,7-di-tert-butil-3-(3,4-dimetilfenil)-3H- benzofuran-2-one (80 to 100 % ë/ë) dhe b) 5,7-di-tert-butil-3-(2,3-dimetilfenil)-3H-benzofuran-2- one (0 to 20 % w/w)	po	jo	jo	5			

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
27	48960	—	9,10-dihidroksi acid stearik dhe oligomeret e tij	po	jo	jo	5			
28	50160	—	di-n-oktilitin bis(n-alkil(C10-C16) merkptoacetate)	po	jo	jo		(10)		
29	50360	—	di-n-oktilitin bis (etil maleate)	po	jo	jo		(10)		
30	50560	—	di-n-oktilitin 1,4-butanediol bis (merkptoacetate)	po	jo	jo		(10)		
31	50800	—	di-n-oktilitin dimaleate, e ri esterifikuar	po	jo	jo		(10)		
32	50880	—	di-n-oktilitin dimaleate, polimeret (n = 2-4)	po	jo	jo		(10)		
33	51120	—	di-n-oktilitin tiobenzoate 2-etileksil merkptoacetate	po	jo	jo		(10)		
34	54270	—	etilhidroksimetilcelulozë	po	jo	jo				
35	54280	—	etilhidroksipropilcelulozë	po	jo	jo				
36	54450	—	yndyma dhe vajra, nga burime ushqimore bimore apo sitazore	po	jo	jo				
37	54480	—	yndyma dhe vajra të hidrogjenuara, nga burime ushqimore bimore apo sitazore	po	jo	jo				
38	55520	—	Fibrat e qelqit	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
39	55600	—	Topa qelqi mikro	po	jo	jo				
40	56360	—	Esteret e glicerolit me acid acetik	po	jo	jo				
41	56486	—	glycerol, esteret me acidet alifatik, te ngopur , linear, me nr cift te atomeve te karbonit (C ₁₄ - C ₁₈) dhe me acid alifatik, te pa ngopur, linear, me nr cift te atomeve te karbonit (C ₁₆ - C ₁₈)	po	jo	jo				
42	56487	—	Esteret e glicerolit me acid butirik	po	jo	jo				
43	56490	—	Esteret e glicerolit me acid erucik	po	jo	jo				
44	56495	—	Esteret e glicerolit me 12-hidroksi-acid tearik	po	jo	jo				
45	56500	—	Esteret e glicerolit me acid laurik	po	jo	jo				
46	56510	—	Esteret e glicerolit me acid linoleik	po	jo	jo				
47	56520	—	Esteret e glicerolit me acid miristik	po	jo	jo				
48	56535	—	Esteret e glicerolit me acid nonanoik	po	jo	jo				
49	56540	—	Esteret e glicerolit me acid oleik	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
50	56550	—	Esteret e glicerolit me acid palmitik	po	jo	jo				
51	56570	—	Esteret e glicerolit me acid propionik	po	jo	jo				
52	56580	—	Esteret e glicerolit me acid ricinoleik	po	jo	jo				
53	56585	—	Esteret e glicerolit me acid stearik	po	jo	jo				
54	57040	—	Ester monooleate gliceroli, me acid askorbik	po	jo	jo				
55	57120	—	Ester monooleate gliceroli, me acid citrik	po	jo	jo				
56	57200	—	Ester monopalmitat gliceroli, me acid ascorbik	po	jo	jo				
57	57280	—	Ester monopalmitat gliceroli, me acid citrik	po	jo	jo				
58	57600	—	Ester monostearate gliceroli, me acid askorbik	po	jo	jo				
59	57680	—	Ester monostearate gliceroli, me acid citrik	po	jo	jo				
60	58300	—	Kripëra glicine	po	jo	jo				
62	64500	—	Kripëra lisine	po	jo	jo				
63	65440	—	mangan pirofosfite	po	jo	jo				
64	66695	—	metilhidroximetilcelulozë	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
65	67155	—	perzierje e 4-(2-benzoxazolil)-4'-(5-metil-2-benzoxazolil)stilbene, 4,4'-bis(2-benzoxazolil) stilbene dhe 4,4'-bis(5-metil-2-benzoxazolil)stilbene	po	jo	jo			Jo më shumë se 0.05% (w/w) (sasia e substancës së përdorur / sasia e formulimit). Përzierje të marra nga procesi i prodhimit në raport tipik të (58-62%) :(23-27%) :(13-17%).	
66	67600	—	mono-n-oktilin tris(alkil(C10-C16) merkaptacetate)	po	jo	jo		(11)		
67	67840	—	acid montanik dhe/ose esteret e tyre me etileneglikol dhe/ose me 1,3-butanediol dhe/ose me glicerol	po	jo	jo				
68	73160	—	acid fosforik, mono- dhe esteret di-n- alkyl (C ₁₆ and C ₁₈)	po	jo	po	0,05			
69	74400	—	acid fosforik, tris(nonil-dhe/ose dinonilfenil) ester	po	jo	po	30			
70	76463	—	Kripëra të acidit poliakrilik	po	jo	jo		(22)		
71	76730	—	polidimetilsiloksan, γ-hidroxiipropilat	po	jo	jo	6			
72	76815	—	poliesteret e acidit Adipik me glicerinë apo pentaeritritol, eteret me numër çift, të pa degëzuar C 12 C 22 acide yndyrore	po	jo	jo		(32)	Fraksioni i peshës molekulare poshtë 1 000 Da nuk duhet të kalojë 5% (w/w)	
73	76866	—	polyesteret e 1,2-propanediol dhe / ose 1,3- dhe / ose 1,4-Butanediol dhe / ose polipropilen glikol me acid Adipik, të cilat mund të jenë të mbuluar me acid acetik ose acide yndyrore C 12 - C 18 ose n -butanol dhe / ose n-dekanol	po	jo	po		(31) (32)		

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
74	77440	—	glikol polietilene diricinoleate	po	jo	po	42			
75	77702	—	estere glikol polietileni i aliph. mono Carb. Acidet (C6-22) dhe amonium e natriumit e sulfateve te tyre	po	jo	jo				
76	77732	—	glikol polietileni (EO = 1-30, në mënyrë tipike 5) eter i butyl 2-ciano 3- (4-hidroksi-3-metoksifenil) akrilat	po	jo	jo	0,05		Vetëm për përdorim në PET	
77	77733	—	glikol polietileni (EO = 1-30, në mënyrë tipike 5) ether of butyl-2-ciano-3- (4-hidroxifenil) akrilik	po	jo	jo	0,05		Vetëm për përdorim në PET	
78	77897	—	glikol polietileni (EO = 1-50) monoalkileter (linear dhe i degëzuar, C8-C20) sulfate, kriperat	po	jo	jo	5			
79	80640	—	polioxiialkil (C ₂ -C ₄) dimetil-polisiloxane	po	jo	jo				
80	81760	—	pluhurat, thekon dhe fibra tunzhi, bronzi, bakri, çeliku inox, kallaj, hekur dhe lidhjet e bakrit, kallaj dhe hekuri	po	jo	jo				
81	83320	—	propilhidroxietilcellulose	po	jo	jo				
82	83325	—	propylhidroximetilcellulose	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
83	83330	—	propilhidroxiopropilcellulose	po	jo	jo				
84	85601	—	Silikate natyrore (me pārjashtim tē asbestit)	po	jo	jo				
85	85610	—	Silikate natyrore, silanated (me pārjashtim tē asbestit)	po	jo	jo				
86	86000	—	acid silicik, sililated	po	jo	jo				
87	86285	—	dioxide silikoni, silanated	po	jo	jo				
88	86880	—	mono alkil natriumi dialkil fenil benzinē di sulfonat	po	jo	jo	9			
89	89440	—	acid stearik, estere me glikol etilen	po	jo	jo		(2)		
90	92195	—	Kripera taurine	po	jo	jo				
91	92320	—	tetradecil-poliētilēneglikol(EO = 3-8) eter te acidit glykolik	po	jo	po	15			
92	93970	—	trīciklodekanedimetanol bis (hexahidroftalate)	po	jo	jo	0,05			

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
93	95858	—	Dyll blete, parafine e rafinuar, derivuar nga nafta baze ose hidrokarbon sintetik waxes, parafinik, refined, që derivon nga nafta bazë ose hidrokarburet sintetike rezervat ushqimore me viskozitet i ulët	po	jo	jo	0,05		Nuk do të përdoret për artikuj në kontakt me ushqimet yndyrrore, për të cilat simulant D është hedhur poshtë. Average molecular weight is less than 350 Da. Viskoziteti në 100 °C jo më pak se 2,5 cSt ($2,5 \times 10^{-6}$ m²/s). Përmbajtja e hidrokarbureve me numër karboni më i vogël se 25, jo më shumë se 40% (w / w).	
94	95859	—	Parafinë e rafinuar, derivon nga nafta bazë ose hidrokarbure sintetike rezervash ushqimore, me viskozitet të lartë	po	jo	jo			Pesha mesatare molekulare jo më pak se 500 Da. Viskoziteti në 100 °C jo më pak se 11 cSt (11×10^{-6} m²/s). Përmbajtja e hidrokarbureve me numër karboni më i vogël se 25, jo më shumë se 5 % (w/w).	
95	95883	—	Vajra minerale të bardhë, parafine, që rrjedhin nga nafta bazuar në hidrokarbure rezervat ushqimore	po	jo	jo			Pesha mesatare molekulare jo më pak se 480 Da. Viskoziteti në 100 °C jo më pak se 8,5 cSt ($8,5 \times 10^{-6}$ m²/s). Përmbajtja e hidrokarbureve minerale me numër karboni më i vogël se 25, jo më shumë se 5 % (w/w).	
96	95920	—	Miell druri dhe fibra, te trajtuar	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
97	72081/10	—	Rezin e hidrokarbureve të naftës, (te hidrojenuara)	po	jo	jo			Rezinat e hidrokarbureve të naftës, të hidrojenuara, janë prodhuar nga katalizimi ose termopolimerizimi i dieneve të llojeve alifatike, aliciklike dhe/ose alkeneve monobenzenoidaril të distilave të shtresave të plasaritura të naftës me zjerje jo më shumë se 220 °C, si dhe monomereve të pastra të gjetura në fraksionet e distilimit, të pasuara me distilim, hidrogjenizim dhe përpunim shtesë. Vetitë: — Viskositeti në 120 °C; > 3 Pa.s, — Pika e zbutjes: > 95 °C siç përcaktohet nga Metoda ASTM E 28-67, — Numri Bromine:<40 (ASTM D1159), — Ngjyra në 50 % solucion toluene < 11 në shkallë Gardner, — Mbetje monomer aromatik ≤ 50 ppm,	
98	17260	0000050-00-0	formaldehide	po	po	jo		(15)		
	54880									
99	19460	0000050-21-5	acid laktik	po	po	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
100	24490	0000050-70-4	sorbitol	po	po	jo				
	88320									
101	36000	0000050-81-7	acid askorbik	po	jo	jo				
102	17530	0000050-99-7	glukose	jo	po	jo				
103	18100	0000056-81-5	glicerol	po	po	jo				
	55920									
104	58960	0000057-09-0	heksadeciltrimetilamonium bromide	po	jo	jo	6			
105	22780	0000057-10-3	acid palmitik	po	po	jo				
	70400									
106	24550	0000057-11-4	acid stearik	po	po	jo				
	89040									
107	25960	0000057-13-6	urea	jo	po	jo				
108	24880	0000057-50-1	sukrose	jo	po	jo				
109	23740	0000057-55-6	1,2-propanediol	po	po	jo				
	81840									
110	93520	0000059-02-9 0010191-41-0	α -tokoferol	po	jo	jo				
111	53600	0000060-00-4	acid etilenediaminetetraacetik	po	jo	jo				
112	64015	0000060-33-3	acid linoleik	po	jo	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
113	16780	0000064-17-5	etanol	po	po	jo				
	52800									
114	55040	0000064-18-6	acid formik	po	jo	jo				
115	10090	0000064-19-7	acid acetik	po	po	jo				
	30000									
116	13090	0000065-85-0	acid benzoik	po	po	jo				
	37600									
117	21550	0000067-56-1	metanol	jo	po	jo				
118	23830	0000067-63-0	2-propanol	po	po	jo				
	81882									
119	30295	0000067-64-1	Acetone	po	jo	jo				
120	49540	0000067-68-5	dimetil sulfoxide	po	jo	jo				
121	24270	0000069-72-7	acid salicilik	po	po	jo				
	84640									
122	23800	0000071-23-8	1-propanol	jo	po	jo				
123	13840	0000071-36-3	1-butanol	jo	po	jo				
124	22870	0000071-41-0	1-pentanol	jo	po	jo				
125	16950	0000074-85-1	Etilene	jo	po	jo				

(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)
126	10210	0000074-86-2	acetilene	jo	po	jo				
127	26050	0000075-01-4	vinil kloride	jo	po	jo	ND		1 mg/kg në produktin final	
128	10060	0000075-07-0	acetaldehyde	jo	po	jo		(1)		
129	17020	0000075-21-8	okside etilene	jo	po	jo	ND		1 mg/kg në produktin final	(10)
130	26110	0000075-35-4	vinilidene kloride	jo	po	jo	ND			(1)
131	48460	0000075-37-6	1,1-difluoroetane	po	jo	jo				
132	26140	0000075-38-7	vinilidene fluoride	jo	po	jo	5			
133	14380	0000075-44-5	karbonil kloride	jo	po	jo	ND		1 mg/kg në produktin final	(10)
	23155									
134	43680	0000075-45-6	klorodifluorometane	po	jo	jo	6		Përbajtja e klorofluorometane më pak se 1 mg / kg të substancës	
135	24010	0000075-56-9	propilene oxide	jo	po	jo	ND		1 mg/kg në produktin final	
136	41680	0000076-22-2	kamfor	po	jo	jo				(3)
137	66580	0000077-62-3	2,2'-metilenebis(4-metil-6-(1-metileiklohexil) fenol)	po	jo	po		(5)		
138	93760	0000077-90-7	tri-n-butil acetil citrate	po	jo	jo		(32)		
139	14680	0000077-92-9	acid citrik	po	po	jo				
	44160									
Simulantët ushqimorë A, B dhe C janë caktuar për ushqimet të cilat kanë karakter hidrofilik dhe janë në gjendje të nxjerrin substancat hidrofilike. Simuluesi ushqimor B duhet të përdoret për ato ushqime të cilat kanë një pH më të ulët se 4.5. Simuluesi ushqimor C duhet të përdoret për ushqime alkoolike me përmbajtje alkooli deri 20% dhe për ato ushqimeve të cilat përmbajnë një sasi të konsiderueshme të përbërësve organike të cilët e bëjnë ushqimin më shumë lipofilik.

Simulantët ushqimorë D1 dhe D2 janë caktuar për ushqime që kanë karakter lipofilik dhe janë në gjendje të ekstrahojnë substanca lipofilike. Simulanti ushqimor D1 duhet të përdoret për ushqime alkoolike me përbërje alkooli mbi 20 % dhe për vaj në emulsione uji. Simulanti ushqimor D2 duhet të përdoret për ushqime të cilat përmbajnë yndyrna të lira në sipërfaqe.

Simulantit ushqimor E i është caktuar testimi i migrimit specifik në ushqimet e thata.

3. Funkzioni specifik i simulantëve ushqimorë të ushqimeve për testimin e migrimit të materialeve dhe artikujve që nuk janë ende në kontakt me ushqimin

Për testimin e migrimit të materialeve dhe artikujve që nuk janë ende në kontakt me ushqimin simulantët ushqimorë që korrespondojnë me një kategori të caktuar ushqimesh duhet të zgjidhen sipas tabelës 2 të mëposhtme.

Për testimin e migrimit të përgjithshëm të materialeve dhe artikujve që mendohet të jenë në kontakt me kategori të ndryshme ushqimesh ose një kombinim i kategorive ushqimore, detyra e simulantit ushqimor në pikën 4 është e aplikueshme.

Tabela 2 përmban informacionin e mëposhtëm:

Kolona 1 (Nr. Reference): përmban numrin e referencës të kategorisë së ushqimit.

Kolona 2 (Përshkrimi i ushqimit): përmban një përshkrim të ushqimeve që mbulohen nga kategoria e ushqimit.

Kolona 3 (Simulantët ushqimorë): përmban nën-kolona për secilin nga simulantët ushqimorë.

Simulanti ushqimor për të cilin është vënë një kryq në nën-kolonën respektive të kolonës 3, do të përdoret kur testimi i emigrimit të materialeve dhe artikujve nuk është ende në kontakt me ushqimin.

Për kategori ushqimesh që ndodhen në nën-kolonën D2 kryqi ndiqet nga një vizë e pjerrët dhe një figurë, rezultati i testimit të migrimit do të ndahet nga kjo figurë para se të krahasohet rezultati me kufirin e migrimit.

Figura përbën faktorin korrigjues të cilit i referohet pika 4.2 e shtojcës V të këtij udhëzimi.

Për kategori ushqimi 01.04 simulanti ushqimor D2 do të zëvendësohet nga 95 % etanol.

Për kategoritë ushqimore të nën-kolonës B ku kryqi ndiqet nga (*) testimi në simulantin ushqimor B mund të hiqet nëse ushqimi ka një pH më të lartë se 4.5.

Për kategoritë ushqimore të nën-kolonës D2 ku kryqi ndiqet nga (**) testimi i simulantit ushqimor D2 mund të hiqet nëse provohet me anë të një testimi të përshtatshëm se në të nuk ka “kontakt yndyror” me materialin plastik në kontakt me ushqimin.

Tabela 2

Kategori specifike e ushqimit në funksion të simulimit ushqimor

(1)	(2)	(3)					
Nr.Referencës	Përshkrimi i ushqimit	Simulanti ushqimor					
		A	B	C	D1	D2	E
01	Pijet						
01.01	Pijet jo alkoolike ose pijet alkoolike me grade alkoolike më të ulët ose të barabartë me 6 % vol.:						
	A. Pije të qarta:		X(*)	X			
	Ujë, verë molle, lëngje frutash ose perimesh të qarta me gradë normale apo të koncentruar, nektare frutash, limonata, shurupe, biter, pije jo alkoolike, pije energjike, kafe, çaj, birra, pije e butë, ujë aromatik, ekstrakt i lëngshëm kafeje						

(1)	(2)	(3)					
		A	B	C	D1	D2	E
	B. pije e turbullt:		X(*)		X		
	Lëngje, nektare dhe pije të buta që përmbajnë pulpë frutash, duhet të përmbajnë pulpë frutash, çokollatë e lëngshme						
01.02	Pije alkoolike me gradë alkoolike midis 6 % vol dhe 20 %.			X			
01.03	Pije alkoolike me gradë alkoolike mbi 20 % dhe të gjitha likeret krem				X		
01.04	Të ndryshme: alkool etilik jo i denaturuar		X(*)			zëvendësues 95 % etanol	
02	Drithërat, produktet e drithrave, ëmbëlsira, biskota, kek dhe prodhime të tjera të furrës						
02.01	Niseshte						X
02.02	Drithëra, të papërpunuara, të fryrë, fleiks (duke përfshirë kokoshka, komfleiks dhe të ngjashme)						X
02.03	Miell drithi dhe misri						X
02.04	Makarona pa lëng si: makarona, spaghetti dhe produkte të ngjashme dhe makarona të freskëta						X
02.05	Pasta, biskota, keke, bukë, dhe produkte të tjera të furrës, pa lëng:						
	A. Me substancë yndyrore në sipërfaqe					X/3	
	B. Të tjera						X
02.06	Pasta, keke, bukë, brumë dhe produkte të tjera të furrës, të freskëta:						
	A. Me substancë yndyrore në sipërfaqe					X/3	
	B. Të tjera						X

(1)	(2)	(3)					
Nr. Referencës	Përshkrimi i ushqinut	Simulantët ushqimorë					
		A	B	C	D1	D2	E
03	Çokollata, sheqer dhe produktet e tyre Produkte të pasticerisë						
03.01	Çokollata, produkte të veshura me çokollatë, zëvendësues dhe produkte të veshura me zëvendësues					X/3	
03.02	Produkte të pasticerisë: A. Në formë të ngurtë: I. Me substancë yndyrore në sipërfaqe II. Të tjera B. Në formë paste: I. Me substancë yndyrore në sipërfaqe II. Të njoma					X/3 X/2	 X
03.03	Sheqer dhe produkte të sheqerit A. Në formë të ngurtë: kristal ose pluhur B. Melase, shurup sheqeri, mjaltë dhe e ngjashme						X
04	Fruta, perime dhe produktet e tyre						
04.01	Frut i plotë, i freskët ose i ftohtë, i pa zhveshur (hequr lëkurën)						
04.02	Fruta të përpunuara: A. Fruta të thata ose të dehidratuara, të plota, të prera në feta, të bëra miell ose pluhur B. Fruta në formë pureje, konserva, xhel ose në lëngun e vet ose në shurup sheqeri (reçel, komposto, dhe produkte të ngjashme) C. Fruta të ruajtura në mjedis të lëngët: I. Në një mjedis me vaj II. Në një mjedis alkoolik	X		X			X
			X(*)	X		X	
					X		

(1)	(2)	(3)					
Nr.Referencës	Përshkrimi i ushqimit	Simulantët ushqimor					
		A	B	C	D1	D2	E
04.03	Arra (kikirikë, gështenja, bajame, lajthi, arra, kokrra pishe dhe të tjera): A. Të qëruara, të thara, të zhveshura nga lëvozhga ose të bëra pluhur B. Të qëruara dhe të pjekura C. Në formë brumi ose kremi	X				X	X
04.04	Perime të plota, të freskëta ose të flohta, të paqëruara						
04.05	Perime të përpunuara: A. Perime të thata ose të dehidratuara, të plota, të prera në feta ose të bëra miell ose pluhur B. Perime të freskëta, të qëruara ose të prera C. Perime në formë pureje, të konservuara, xhel ose në lëngun e vet (duke përfshirë turshinë në shëllirë) D. Perime të konservuara: I. Në mjedis me vaj II. Në mjedis alkoolik	X	X(*)	X	X	X	X
05	Yndyrërat dhe vajrat						
05.01	Yndyrëra dhe vajra bimore dhe shtazore, natyrale ose të trajtuara (duke përfshirë gjalpë kakao, sallo, gjalp)					X	
05.02	Margarinë, gjalp dhe yndyrëra të tjera dhe vajra të prodhuara nga emulsion të ujit në vaj					X/2	
06	Produktet me origjinë shtazore dhe vezët						
06.01	Peshk: A. I freskët, i flohtë, i përpunuar, i kripur apo i tymosur, duke përfshirë dhe vezë peshku	X				X/3(**)	

(1)	(2)	(3)					
Nr. Referencës	Përshkrimi i ushqimit	Simulantët ushqimor					
		A	B	C	D1	D2	E
06.02	B. Peshk i konservuar:						
	I. Në mjedis me vaj	X				X	
	II. Në mjedis ujor		X(*)	X			
	Krustacet dhe molusqet (duke përfshirë ostrika, midhjet, kërmijtë)						
06.03	A. Guaskë e freskët						
	B. Të hequra nga guaska, të përpunuara, konservuara ose gatuar me guaskë						
	I. Në mjedis me vaj	X				X	
	II. Në mjedis ujor		X(*)	X			
06.04	Mish i të gjitha llojeve të kafshëve zoologjike (duke përfshirë shpendët dhe shpendët e gjuetisë):						
	A. I freskët, i ftohtë, i kriposur, i tymosur	X				X/4(**)	
	B. Produkte të përpunuara të mishit (të tilla si proshutë kofshe, sallam, proshute, salcice dhe të tjera) ose në formë brumi kremi	X				X/4(**)	
	C. Produkte mishi të marinuara në mjedis vajor	X				X	
06.05	Konserva mishi:						
	A. Në yndyrë ose mjedis me vaj	X				X/3	
	B. Në mjedis ujor		X(*)		X		
	Vezë e plotë, e verdhë veze, e bardhë veze						
07.01	A. Pluhur i thatë ose i ngrirë						X
	B. Të lëngshme dhe të gatuar				X		
	Produktet e qumështit						
	Qumësht						
07.01	A. Qumësht dhe pije me bazë qumështu, pjesërisht të thata dhe të skremuara ose pjesërisht e skremuar				X		

(1)	(2)	(3)					
Nr. References	Pershkrimi i ushqimit	Simulanti ushqimor					
		A	B	C	D1	D2	E
	B. Qumësht pluhur duke përfshirë formulat e foshnjave (bazuar në qumësht pluhuri të plotë)						X
07.02	Qumësht i fermentuar si kos, dhallë dhe produkte të ngjashme		X(*)		X		
07.03	Krem dhe salcë kosi		X(*)		X		
07.04	Djathura:						
	A. E plotë, me lëkurë jo të ngrënshme						X
	B. Djath natyral pa lëkurë ose me lëkurë të ngrënshme (gouda, kamembert, dhe të ngjashme) dhe djath i shkrirë					X/3(**)	
	C. Djath i përpunuar (djath i bute, gjize dhe të ngjashme)		X(*)		X		
	D. Djath i konservuar:						
	I. Në mjedis me vaj	X				X	
	II. Në mjedis ujor (feta, mozzarella, dhe të ngjashme)		X(*)		X		
08	Produkte të ndryshme						
08.01	Uthull		X				
08.02	Ushqime të skuqur ose të pjekur:						
	A. Patate të skuqura, fritte dhe të ngjashme	X				X/5	
	B. Me origjinë shtazore	X				X/4	
08.03	Përgatitje për supra, supë me lëng mishi, salca, në formë të lëngshme, të ngurtë ose pluhur (ekstrakte, të përqëndruara); përgatitje ushqimore të përbëra të homogjenizuara, gjellë të përgatitura duke përfshirë maja dhe agjentët ngrirës						
	A. Pluhur ose të thara:						
	I. Me karakter yndyror					X/5	
	II. Të tjera						X

(1)	(2)	(3)					
Nr. References	Pershkrimi i ushqimit	Simulantet ushqimor					
		A	B	C	D1	D2	E
	B. Ndonjë formë tjetër përveç pluhur ose të thara:						
	I. Me karakter yndyror	X	X(*)			X/3	
	II. Të tjera		X(*)	X			
	Salca:						
08.04	A. Me karakter ujor		X(*)	X			
	B. Me karakter yndyror psh. majoneza, salca me prejardhje nga majoneza, krem sallate dhe përzierje të tjera vaj/ujë psh. salca me bazë kokosi	X	X(*)			X	
08.05	Mustard (përveç mustardë pluhur nën 08.14)	X	X(*)			X/3(**)	
08.06	Sandnice, tost buke pizza dhe të ngjashme që përmbajnë një lloj produkti ushqimor						
	A. Me substancë yndyrore në sipërfaqe	X				X/5	
	B. Të tjera						X
08.07	Akulloret			X			
08.08	Ushqime të thata:						
	A. Me substancë yndyrore në sipërfaqe					X/5	
	B. Të tjera						X
08.09	Ushqime të ngrira ose të ngrira thellë						X
08.10	Ekstrakte të koncentruar me gradë alkoolike të barabartë apo më tepër se 6% në vol		X(*)		X		
08.11	Kakao:						
	A. Kakao pluhur duke përfshirë yndyrë të reduktuar dhe nivel të lartë yndyre të reduktuar						X
	B. Kakao brumë					X/3	

(1)	(2)	(3)					
Nr. References	Pershkrimi i ushqimit	Simulantet ushqimore					
		A	B	C	D1	D2	E
08.12	Kafë, e pjekur ose jo e pjekur, dekafeinato ose e tretshme, zëvendësues kafë, e ashpër ose pluhur						X
08.13	Bimë aromatike dhe bimë të tjera si kamomili, malloë, nenexhik, çaj, çaj blini etj.						X
08.14	Erëza dhe erëza në gjëndje tyrale natyrale si kanelle, karafil, mustardë piper, vanilje, shafiran, kripe etj.						X
08.15	Erëza dhe erëza në mjedis me vaj si pesto, paste kerri.					X	

4. Detyra e simulantit ushqimor për testimin e përgjithshëm të migrimit

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve, do të kryhen testime në ujë të distiluar ose në ujë të një cilësie ekuivalente ose simulantit ushqimor A, B dhe D2.

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve përveç ushqimeve acide, do të kryhen testimet në ujë të distiluar ose në ujë të një cilësie ekuivalente ose simulantit ushqimor A dhe D2.

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve të lëngshme dhe alkoolike dhe produkteve të qumështit, do të kryhet testimi në simulantin ushqimor D1.

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve të lëngshme, acide dhe alkoolike dhe produkteve të qumështit, do të kryhen testimet në simulantin ushqimor D1 dhe simulantin ushqimor B.

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve të lëngshme dhe alkoolike me përmbajtje alkooli deri në 20% do të kryhet testimi në simulantin ushqimor C.

Për të treguar përputhshmërinë me kufirin e përgjithshëm të migrimit për të gjitha llojet e ushqimeve të lëngshme, acide dhe alkoolike me përmbajtje alkooli deri në 20%, do të kryhen testimet në simulantin ushqimor C dhe simulantin ushqimor B.

SHTOJCA IV

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

Deklarata e shkruar, referuar në pikat 36, 37 dhe 38, duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1. Identitetin dhe adresën e operatorit të biznesit që lëshon deklaratën e përputhshmërisë;
2. Identitetin dhe adresën e operatorit të biznesit i cili prodhon ose importon materialet ose artikujt plastikë ose produkte të fazave të ndërmjetme të prodhimit të tyre ose substancave të nevojshme për prodhimin e materialeve ose artikujve;

3. Identitetin e materialeve, artikujve, produkteve të fazave të ndërmjetme të prodhimit të tyre ose substancave të nevojshme për prodhimin e materialeve ose artikujve;

4. Datën e deklaratës;

5. Konfirmimin që materialet ose artikujt plastike, produkte të fazave të ndërmjetme të prodhimit ose që substancat plotësojnë kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në udhëzimin nr. 15, datë 13.12.2012, “Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet”;

6. Informacionin e përshtatshëm në lidhje me substancat në përdorim ose produkteve të degradimit kufizimet dhe/ose specifikimet, të cilat janë të përcaktuara në shtojcat I dhe II të këtij udhëzimi, për të lejuar operatorët e biznesit të sigurojnë përputhshmërinë me këto kufizime;

7. Informacionin e përshtatshëm në lidhje me substancat të cilat janë subjekt i kufizimeve në ushqim, të përcaktuara nga të dhëna eksperimentale ose llogari teorike rreth nivelit të tyre të migrimit specifik dhe aty ku është e përshtatshme, kriteri i pastërtisë në përputhje me udhëzimin nr. 6, datë 27.5.2011, “Mbi përcaktimin e kriterit të pastërtisë në lidhje me ëmbëlsuesit e përdorur në ushqime”, urdhrin nr. 5, datë 9.1.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi kontrollin e kriterit të pastërtisë për disa aditive të autorizuar”” dhe urdhrin nr. 4, datë 9.1.2007, “Për miratimin e rregullores “Mbi kriterin e pastërtisë së aditivëve ushqimorë të tjerë nga ngjyruarit dhe ëmbëlsuesit”” për të mundësuar që përdoruesit e këtyre materialeve apo artikujve të përmbushin dispozitat përkatëse të BE-së ose në mungesë të tyre, dispozitat kombëtare të aplikueshme mbi ushqimin;

8. Specifikime në përdorimin e materialit ose artikullit, të tilla si:

i) llojin apo llojet e ushqimit me të cilin mendohet të vihet në kontakt;

ii) kohën dhe temperaturën e trajtimit dhe ruajtjes në kontakt me ushqimin;

iii) raporti i zonës së sipërfaqes së kontaktit me ushqimin me vëllimin që përdoret për të përcaktuar përputhshmërinë e materialit apo artikullit;

9. Kur një pengesë funksionale është përdorur në një material me shumë shtresa ose artikull, konfirmimi se materiali ose artikulli është në përputhje me kërkesat e pikave 26, 27, 28 dhe pikat 31, 32 të këtij udhëzimi.

SHTOJCA V

TESTIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Për testimin e përputhshmërisë së emigrimit nga materialet dhe artikujt plastike në kontakt me ushqimin, aplikohen rregullat e përgjithshme të mëposhtme.

KAPITULLI 1

TESTIMI PËR MIGRIMIN SPECIFIK TË MATERIALEVE DHE ARTIKUJVE QË TANIMË JANË NË KONTAKT ME USHQIMIN

1.1 Përgatitja e mostrës

Materiali ose artikulli do të ruhet siç tregohet në etiketën e ambalazhit ose në kushtet e përshtatshme për ushqimet e paketuara nëse nuk jepen udhëzime. Ushqimi do të hiqet nga kontakti me materialin ose artikullin para datës së skadencës ose çdo date tjetër në të cilën prodhuesi ka treguar se produkti do të përdoret për arsye cilësie dhe sigurie .

1.2 Kushtet e testimit

Ushqimi do të trajtohet në përputhje me udhëzimet e gatimit në ambalazh në rast se ushqimi do të gatuhet në ambalazh. Pjesë të ushqimit të cilat nuk janë bërë për t'u konsumuar do të hiqen dhe hidhen. Pjesa e mbetur do të homogjenizohet dhe analizohet për migrim. Rezultatet analitike do të shprehen gjithnjë mbi bazën e masës së ushqimit që mendohet të konsumohet në kontakt me materialin e kontaktit me ushqimin.

1.3 Analiza e substancave të migruara

Migrimi specifik analizohet në ushqim duke përdorur një metode analitike në përputhje me kërkesat

e Nenit 11 të urdhrit nr. 382, datë 31.7.2006, “Për miratimin e rregullores “Mbi organizimin e kontroleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve e të kafshëve dhe rregullat për shëndetin, si dhe mirëqenien e kafshëve””.

1.4 Raste të veçanta

Kur ndodh kontaminimi nga burime të ndryshme nga materialet e kontaktit me ushqimin kjo duhet të merret parasysh kur kryhet testimi i përputhshmërisë së materialeve të kontaktit me ushqimin, në veçanti për ftalatet (phthalates) (substancat FCM 157,159,283,728,729) të referuara në shtojcën I.

KAPITULLI 2

TESTIMI PËR MIGRIMIN SPECIFIK TË MATERIALEVE DHE ARTIKUJVE QË NUK JANË ENDE NË KONTAKT ME USHQIMIN

2.1 Metoda e verifikimit

Verifikimi i përputhshmërisë së migrimit të ushqimit me kufijtë e migrimit do të kryhet nën kushtet më ekstreme të kohës dhe temperaturës të parashikueshme në përdorimin aktual duke marrë parasysh paragrafët 1.4, 2.1.1, 2.1.6 dhe 2.1.7.

Verifikimi i përputhshmërisë së migrimit në simulantët ushqimorë me kufijtë e migrimit do të kryhet duke përdorur testime migrimi tradicionale sipas rregullave të përcaktuara në paragrafët 2.1.1 deri në 2.1.7.

2.1.1 Përgatitja e mostrës

Materiali ose artikulli do të trajtohet siç është përshkruar shoqëruar me udhëzime ose sipas dispozitave të dhëna në deklaratën e përputhshmërisë.

Migrimi është përcaktuar në materialin ose artikullin ose, nëse kjo është jo praktike, në një mostër të marrë nga një mostër përfaqësuese e këtij materiali ose artikulli. Për çdo simulant ushqimor ose llojin e ushqimit, është përdorur një formë e re test. Vetëm ato pjesë të mostrës të cilat janë të destinuara të jene në kontakt me ushqimin në përdorim aktual do të vendosen në kontakt me simulantin ushqimor apo ushqimin.

2.1.2 Zgjedhja e simulantit ushqimor

Materialet dhe artikujt e destinuar të jenë në kontakt me të gjitha llojet e ushqimit, do të testohen me simulant ushqimi A, B dhe D2. Megjithatë, nëse substancat që mund të reagojnë me simulantin ushqimor acid ose ushqimet acide, nuk janë të pranishme gjatë testimit të ushqimit, simulant B mund të hiqet.

Materialet dhe artikujt e destinuar vetëm për lloje të veçanta të ushqimeve duhet të testohen me simulantët e ushqimit treguar për llojet e ushqimeve në shtojcën III.

2.1.3 Kushtet e kontaktit, gjatë përdorimit të simulantit ushqimor

Mostra duhet të vendoset në kontakt me simulantin ushqimor në një mënyrë që të paraqesë kushte të këqija të parashikuara gjatë përdorimit, sa i përket kohës së kontaktit në tabelën 1 dhe temperaturës së kontaktit në tabelën 2 .

Në qoftë se është gjetur se kryerja e testeve në bazë të kombinimit të kushteve të kontaktit të përcaktuara në tabelat 1 dhe 2, shkaqet fizike apo ndryshime të tjera në mostrën e testimit nuk ndodhin në kushtet e këqija të parashikueshme të përdorimit të materialit apo artikullit në shqyrtim, testet e migrimit do të kryhen në kushtet më të këqija të parashikuara të përdorimit në të cilën këto ndryshime fizike ose të tjera nuk ndodhin.

Tabela 1
Koha e kontaktit

Periudha e kontaktit në përdorim të keq të parashikueshëm	Koha e testit
$t \leq 5 \text{ min}$	5 min
$5 \text{ min} < t \leq 0,5 \text{ orë}$	0,5 orë
$0,5 \text{ ore} < t \leq 1 \text{ orë}$	1 orë
$1 \text{ ore} < t \leq 2 \text{ orë}$	2 orë
$2 \text{ ore} < t \leq 6 \text{ orë}$	6 orë
$6 \text{ ore} < t \leq 24 \text{ orë}$	24 orë
$1 \text{ dite} < t \leq 3 \text{ ditë}$	3 orë
$3 \text{ dite} < t \leq 30 \text{ ditë}$	10 orë
Mbi 30 ditë	Shih kushtet specifike

Tabela 2
Temperatura e kontaktit

Kushtet e kontaktit në përdorim të keq të parashikueshëm	Kushtet e testit
Temperatura e kontaktit	Temperatura e testit
$T \leq 5^{\circ}\text{C}$	5°C
$5^{\circ}\text{C} < T \leq 20^{\circ}\text{C}$	20°C
$20^{\circ}\text{C} < T \leq 40^{\circ}\text{C}$	40°C
$40^{\circ}\text{C} < T \leq 70^{\circ}\text{C}$	70°C
$70^{\circ}\text{C} < T \leq 100^{\circ}\text{C}$	100°C ose temperaturë e refluksit
$100^{\circ}\text{C} < T \leq 121^{\circ}\text{C}$	121°C (*)
$121^{\circ}\text{C} < T \leq 130^{\circ}\text{C}$	130°C (*)
$130^{\circ}\text{C} < T \leq 150^{\circ}\text{C}$	150°C (*)
$150^{\circ}\text{C} < T < 175^{\circ}\text{C}$	175°C (*)
$T > 175^{\circ}\text{C}$	Rregullo temperaturën në temperaturën reale të sipërfaqes me ushqimin (*)

(*) Kjo temperaturë do të përdoret vetëm për simulantët ushqimorë D2 dhe E. Për aplikimet me nxehtësi nën presion, testimi migrimit mund të kryhet nën presion në temperaturë të përshtatshme. Për simulantët ushqimorë A, B, C ose D1 testi mund të zëvendësohet nga një test në 100°C ose në temperaturë refluks për kohëzgjatjen prej katër orësh të kohës së zgjedhur sipas kushteve në tabelën 1.

2.1.4 Kushtet specifike për kohën e kontaktit mbi 30 ditë në temperaturë dhome dhe më të ulët

Për kohën e kontaktit mbi 30 ditë në temperaturë dhome dhe nën të, mostra do të testohet në një test të përshpejtuar në temperaturë të ngritur për një maksimum prej 10 ditë në 60°C. Koha e testimit dhe kushtet e temperaturës do të bazohen në formulën e mëposhtme.

$$t_2 = t_1 * \text{Exp}((-E_a / R) * (1 / T_1 - 1 / T_2))$$

E_a është rasti më i keq i aktivizimit të energjisë 80kJ / mol

R është faktor 8,31 J / Kelvin / mol

Exp -9627 * (1 / T_1 - 1 / T_2)

t_1 është koha e kontaktit

t_2 është koha e testimit

T_1 është temperatura e kontaktit e shprehur në Kelvin. Për ruajtjen e temperaturës së dhomës kjo është vendosur në 298 K (25°C). Për kushtet frigoriferike dhe të ngrirjes është vendosur në 278 K (5°C).

T_2 është temperatura e testimit shprehur në Kelvin.

Testimi për 10 ditë në 20°C do të mbulojë të gjithë kohën e magazinimit në gjendje të ngrirë.

Testimi për 10 ditë në 40°C do të mbulojë kohën e ruajtjes në kushte frigoriferike dhe në ngrirje, duke përfshirë ngrohje deri në 70°C për 2 orë, ose ngrohje deri në 100°C për 15 minuta.

Testimi për 10 ditë në 50°C do të mbulojë kohën e ruajtjes në kushte frigoriferike dhe në ngrirje, duke përfshirë ngrohje deri në 70°C deri në 2 orë, ose ngrohje deri në 100°C për 15 minuta dhe kohën e magazinimit deri në 6 muaj në temperaturën e dhomës.

Testimi për 10 ditë në 60°C do të mbulojë periudhën e ruajtjes afatgjatë mbi 6 muaj në temperaturën e dhomës dhe më poshtë, duke përfshirë ngrohje deri në 70°C për 2 orë, ose ngrohje deri në 100°C për 15 minuta.

Temperatura maksimale e testimit udhëhiqet nga temperatura e fazës së tranzicionit të polimerit. Në temperaturën provë mostra e testuar nuk duhet të pësojë ndryshime fizike.

Për magazinimin në dhomë, koha e testimit të temperaturës mund të reduktohet në 10 ditë në 40°C në qoftë se ka prova shkencore se migrimi i substancës përkatëse në polimer ka arritur baraspeshim në këtë gjendje prove.

2.1.5 Kushtet specifike për kombinime të kohës kontaktit dhe temperaturës

Në qoftë se një material apo artikull është menduar për aplikime të ndryshme që mbulojnë kombinime të ndryshme të kohës së kontaktit dhe temperaturës, testimi duhet të kufizohet në kushtet e testimit të cilat janë të njohura të jenë më të rënda në bazë të provave shkencore.

Nëse materiali ose artikulli është menduar për një aplikim në kontakt me ushqimin ku është subjekt i suksesshëm, kombinimi i dy ose më shumë herë kohe dhe temperature, testi migrimit duhet të kryhet nënshtruar në mostrën e testimit në të gjitha kushtet e zbatueshme më të këqija të parashikuara përkatëse të mostrës, duke përdorur të njëjtën pjesë të simulantit ushqimor.

2.1.6 Artikuj të përdorimit të përsëritura

Nëse material ose artikulli është menduar të jetë në kontakt të përsëritur me ushqimet, testi(et) i migrimit do të kryhet tre herë në një mostër të vetme duke përdorur një pjesë të simulant ushqimor në çdo rast. Përputhshmëria e tij do të kontrollohet në bazë të nivelit të migrimit gjetur në testin e tretë.

Megjithatë, në qoftë se ka prova bindëse se niveli i migrimit nuk rritet në testet e dytë dhe të tretë dhe në qoftë se kufijtë e migrimit nuk tejkalohen në testin e parë, nuk është e nevojshme asnjë provë e mëtejshme.

Materiali ose artikulli duhet të respektojë kufirin specifik të migrimit tashmë në testin e parë për substancat për të cilat në shtojcën I, tabelën 1, kolona 8 ose tabela 2, kolona 3, kufiri specifik i migrimit është vendosur si jodallueshëm dhe për substanca jo të listuara të përdorura pas një pengese plastike funksionale mbuluar nga rregullat e pikës “b”, të nenit 13 (2), i cili nuk duhet të migrojë në sasi të dallueshme.

2.1.7 Analiza e substancave migruese

Në fund të kohës së parashikuar të kontaktit, migrimi specifik është analizuar në ushqim ose simulant ushqimor duke përdorur një metodë analitike, në përputhje me kërkesat e nenit 11, të urdhrit nr. 382, datë 31.7.2006, “Për miratimin e rregullores “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve e të kafshëve dhe rregullat për shëndetin, si dhe mirëqenien e kafshëve””.

2.1.8 Verifikimi i pajtueshmërisë me përmbajtjen e mbetur për sipërfaqe kontakti të ushqimit (QMA)

Për substancat të cilat janë të paqëndrueshme në simulantin ushqimor ose ushqim apo për të cilat nuk është në dispozicion asnjë metodë adekuate analitike, është treguar në shtojcën I që verifikimi i pajtueshmërisë duhet të merret përsipër nga verifikimi i përmbajtjes së mbetur për 6 dm² të sipërfaqes së kontaktit. Për materialet dhe artikujt në mes të 500 ml dhe 10 l është aplikuar sipërfaqja reale e kontaktit. Për materialet dhe artikujt më poshtë 500 ml dhe mbi 10 l, gjithashtu si për nenet për të cilat është jopraktike për t’u llogaritur sipërfaqja reale e kontaktit, sipërfaqja e kontaktit është supozuar të jetë 6 dm² për kg ushqim.

2.2 Qasjet e shqyrtimit

Për të parë në qoftë se një material apo artikull është në përputhje me kufirin e migrimit mund të aplikohen ndonjë nga metodat e mëposhtme të cilat konsiderohen më të rënda se metoda e verifikimit të përshkruar në seksionin 2.1.

2.2.1 Zëvendësimi i migrimit specifik me migrimin e përgjithshëm

Për të parë migrimin specifik të substancave jo-të avullueshme mund të aplikohet përcaktimi i migrimit të përgjithshëm nën kushtet e testimit si për migrimin specifik.

2.2.2 Përmbajtja e mbetur

Për të parë migrimin specifik, migrimi potencial mund të llogaritet në bazë të përmbajtjes së mbetur të substancës në material ose artikull duke supozuar migrim të plotë.

2.2.3 Modelimi migrimit

Për të parë migrimin specifik, potenciali migrimi mund të llogaritet në bazë të përmbajtjes së mbetur të substancës në material ose artikull duke aplikuar modele përgjithësisht të njohura difuzionit të bazuara në dëshmi shkencore që janë ndërtuar të tilla që të mbivlerësohet migrimi i vërtetë.

2.2.4 Zëvendësues simulant ushqimor

Për të parë migrimin specifik, simulantët e ushqimit mund të zëvendësohen me simulantët e ushqimit zëvendësues në qoftë se është e bazuar në prova shkencore se simulantët e ushqimit zëvendësues mbivlerësojnë migrimin në krahasim me simulantët e përshtatshëm të ushqimit.

KAPITULLI 3

TESTIMI PËR MIGRIMIN E PËRGJITHSHËM

Testimi i përgjithshëm i migrimit do të kryhet sipas kushteve të standardizuara të testimit të përcaktuara në këtë kapitull.

3.1 Kushtet e standardizuara të testimit

Testi i përgjithshëm i migrimit për materialet dhe artikujt të destinuara për të qenë në kontakt me ushqimin të përshkruara në kolonën 3 të tabelës 3 do të bëhet për kohë të caktuar dhe në temperaturën e specifikuar në kolonën 2. Për OM5 provë testi mund të kryhet ose për 2 orë në 100°C (simulant ushqimor D2) ose në refluks (simulant ushqimorë A, B, C, D1) ose për 1 orë në 121°C. Simulantët ushqimorë do të zgjidhen në përputhje me aneksin III.

Në qoftë se është gjetur se kryerja e testeve sipas kushteve të kontaktit të specifikuara në tabelën 3 shkakton ndryshime fizike ose të tjera në mostrën e testimit të cilat nuk ndodhin në kushte më të këqija të parashikuara të përdorimit të materialit apo artikullit në shqyrtim, testet e migrimit do të kryhen nën kushtet më të këqija të parashikuara të përdorimit në të cilën këto ndryshime fizike ose të tjera nuk ndodhin.

Tabela 3
Kushtet e standardizuara të testimit

Kolona 1	Kolona 2	Kolona 3
Test numër	Koha e kontaktit në ditë ose orë kontakt temperature in [°C]	Kushtet e menduara në kontakt me ushqimin
OM1	10 ditë në 20°C	Çdo kontakt ushqimor në kushte të ngrira dhe në frigorifer
OM2	10 ditë në 40°C	Çdo ruajtje afatgjatë në temperaturën e dhomës ose më poshtë, duke përfshirë ngrohjen deri në 70°C për më shumë se 2 orë, ose ngrohjen deri në 100°C për 15 minuta.
OM3	2 orë në 70°C	Çdo kusht kontakti që përfshin ngrohje deri në 70°C për 2 orë, ose deri në 100°C për 15 minuta, të cilat nuk janë ndjekur nga ruajtje për kohë të gjatë në temperaturë dhomë ose frigorifer
OM4	1 orë në 100°C	Aplikim temperature të lartë për të gjithë simulantët ushqimorë në temperaturë deri në 100°C.
OM5	2 orë në 100°C ose në refluks ose deri në 121°C. në mënyrë alternative 1orë në 121°C	Aplikim në temperaturë të lartë
OM6	4 orë në 100°C ose në refluks	Çfarëdo kushte kontakt me ushqimin me simulantët ushqimorë A, B ose C, në temperaturë që i kalon 40°C.
OM7	2 orë në 175°C	Aplikimet me temperaturë të lartë me ushqimet yndyrore që tejkalojnë kushtet e OM5.

Test OM 7 përfshin kushtet e kontaktit të ushqimit të përshkruara për OM1, OM2, OM3, OM4, OM5. Ajo përfaqëson kushtet më të këqija të rasteve për simulantët e ushqimeve yndyrore në kontakt me jopoliolefinat. Në rast se kjo nuk është teknikisht e mundur për të kryer OM 7 me simulantin ushqimor D2, testi mund të zëvendësohet siç është përcaktuar në paragrafin 3.2.

Test OM 6 mbulon edhe kushtet e kontaktit të ushqimit të përshkruara për OM1, OM2, OM3, OM4 dhe OM5. Ajo përfaqëson kushtet më të këqija të rasteve për simulantët ushqimorë A, B dhe C në kontakt me jopoliolefinat.

Test OM 5 mbulon edhe kushtet e kontaktit të ushqimit të përshkruara për OM1, OM2, OM3, OM4. Ajo përfaqëson kushtet më të këqija të rasteve për të gjithë simulantët ushqimorë në kontakt me poliolefinat.

Test OM 2 mbulon edhe kushtet e kontaktit të ushqimit të përshkruara për OM1 dhe OM3.

3.2 Testi zëvendësues për OM7 me simulant ushqimor D2

Në rast se kjo është teknikisht e realizueshme për të kryer OM7 me simulant ushqimor D2 testi mund të zëvendësohet nga testi OM 8 ose OM9. Të dy kushtet e testit të përshkruara nën testin përkatës do të kryhen me një mostër të re test.

Numër testi	Kushtet e testit	Kushtet e destinuarat në kontakt me ushqimin	Mbulon kushtet e destinuarat të kontaktit të ushqimit të përshkruara në
OM 8	Simulanti ushqimor E për 2 orë në 175°C dhe simulanti ushqimor D2 për 2 orë në 100°C	Aplikim vetëm në temperaturë të lartë	OM1, OM3, OM4, OM5, dhe OM6
OM 9	Simulanti ushqimor E për 2 orë në 175°C dhe simulanti ushqimor D2 për 10 ditë në 40°C	Aplikim në temperaturë të lartë duke përfshirë kohë të gjatë ruajtjeje në temperaturë dhome	OM1, OM2, OM3, OM4, OM5 dhe OM6

3.3 Artikuj të përdorimit të përsëritura

Kur një material apo artikull është menduar të jetë në kontakt të përsëritur me ushqime, testi migrimit do të kryhet tre herë në një mostër të vetme duke përdorur një mostër të simulantit ushqimit në çdo rast.

Përputhshmëria e tij do të kontrollohet në bazë të nivelit të migrimit gjetur në testin e tretë.

Megjithatë, në qoftë se ka prova bindëse se niveli i migrimit nuk rritet në testet e dytë dhe të tretë dhe nëse kufiri i përgjithshëm i migrimit nuk është tejkaluar në testin e parë, nuk është e nevojshme asnjë provë e mëtejshme.

3.4 Qasjet e shqyrtimit

Për të kontrolluar nëse një material apo artikull është në përputhje me kufirin e migrimit mund të aplikohen ndonjë nga metodat e mëposhtme, të cilat konsiderohen më të rënda se metodat e verifikimit të përshkruar në seksionet 3.1 dhe 3.2.

3.4.1 Përmbajtja e mbetur

Për të kontrolluar migrimin e përgjithshëm potenciali migrimit mund të llogaritet në bazë të përmbajtjes së mbetur të substancave migratable të përcaktuara në ekstraktimin e plotë të materialit apo artikullit.

3.4.2 Zëvendësuesi simulanti ushqimor

Për të kontrolluar migrimi e përgjithshëm të simulantëve ushqimorë mund të zëvendësohet, nëse bazohet në prova shkencore se simulantët e ushqimit zëvendësues mbivlerësojnë migrimin në krahasim me simulantët e rregullt të ushqimit.

KAPITULLI 4

FAKTORËT E KORRIGJIMIT APLIKUAR KUR KRAHASOJMË REZULTATET E TESTIMIT TË MIGRIMIT ME KUFIJTË E MIGRIMI

4.1 Korrigjimi i migrimit të veçantë në ushqime që përmbajnë më shumë se 20% yndyrë nga Faktori i Reduktimit të Yndyrës (FRY)

Për substancat lipofilike për të cilat në shtojcën I është treguar në kolonën 7 se FRY-ja është i aplikueshëm, migrimi specifik mund të korrigohet nga FRY. FRY-ja përcaktohet sipas formulës

$$\text{FRY} = (\text{g yndyrë në ushqim} / \text{kg e ushqimit}) / 200 = (\% \text{ yndyrë} \times 5) / 100.$$

FRY-ja do të zbatohet sipas rregullave të mëposhtme.

Rezultatet e testit të migrimit do të ndahen nga FRY-ja përpara krahasimit me kufijtë e migrimit.

Korrigjimi nga FRY-ja nuk zbatohet në rastet e mëposhtme:

a) kur materiali ose artikulli është, ose mendohet të jetë në kontakt me ushqime të destinuarat për foshnjat dhe fëmijët e vegjël të përcaktuara në urdhrin nr. 456, datë 17.12.2007, “Mbi miratimin e

rregullores “Për formulat ushqimore për foshnja dhe formulat rrjedhëse” dhe urdhrin nr. 94, datë 28.3.2010, “Për miratimin e rregullores “Mbi ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për foshnjë dhe për fëmijë të vegjël””;

b) për materialet dhe artikujt për të cilat është e pamundur për të vlerësuar marrëdhëniet në mes të sipërfaqes dhe sasinë e ushqimit në kontakt me to, për shembull për shkak të formës ose përdorimit të tyre, dhe migrimi është llogaritur duke përdorur zona konvencionale të sipërfaqes /faktori i konvertimit të vëllimit $6\text{dm}^2/\text{kg}$.

Aplikimi i FRY nuk do të çojë në një migrim specifik që tejkalon kufirin e përgjithshëm të migrimit.

4.2 Korrigjimi i migrimit në simulantin ushqimor D2

Për kategoritë e ushqimit, ku në nën-kolonë D2 të kolonës 3 të tabelës 2 të Aneksit III kryqi është ndjekur nga një figurë rezultati i testit të migrimit në simulantin ushqimor D2 do të ndahet nga kjo figurë.

Rezultatet e testit të migrimit do të ndahen nga faktori korrektues para krahasimit me kufijtë e migrimit.

Korrigjimi nuk është i zbatueshëm për migrimin specifik të substancave në listën Bashkimit në shtojcën I për të cilat afati specifik i migrimit në kolonën 8 është “nuk është i dallueshëm” dhe për substanca jo të listuara të përdorura pas një barriere plastike funksionale të mbuluar nga rregullat e nenit 13 (2) (b) i cili nuk duhet migrojë në sasi të detektueshme.

4.3 Kombinimi i korrigjimit të faktorëve 4.1 dhe 4.2.

Faktorët e korrigjimit të përshkruar në 4.1 dhe 4.2 mund të kombinohen për migrimin e substancave për të cilat FRY-ja është e aplikueshme kur testimi është kryer në simulantin ushqimor D2, duke shumëzuar dy faktorë. Maksimumi i faktorit të aplikuar nuk duhet të kalojë 5.